



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1454, datë 03.12.2010**

**Për**

**“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.12. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

### **K Ë SH I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 50 e datës 17.11.2010, (AKEP: 3361 prot, datë 18.11.2010) “**Ankimim Administrativ**” drejtuar AKEP dhe për dijeni Vodafone AL sh.a, bashkëlidhur korespondenca shkresore midis sipërmarrësve në lidhje me mosmarreveshjen e krijuar midis tyre, si më poshtë vijon:

1. FAX-i me nr. TD/CN/994/ND, datë 02.10.2010, i dërguar nga Vodafone AL për Neofone “Njoftim për ndarjen e kapaciteteve të interkoneksionit në varësi të llojit të trafikut”;
2. Shkresa e Neofone nr.41, datë 07.10.2010 drejtuar Vodafone AL për dijeni AKEP “Përgjigje e shkresës së Vodafone AL me numer reference TD/CN/994/ND”, bashkëlidhur tabela e rishikimit të trafikut midis Neofone dhe Vodafone AL;
3. Shkresë e Neofone nr. 42 prot, datë 12.10.2010 “Kërkesë për fillimin e negociatave dypalëshe për përcaktimin e çmimit të terminimit për thirrjeve ndërkombëtare”, drejtuar Vodafone, për dijeni AKEP;
4. Shkresë e Vodafone AL, me nr. reference LGD/0319/OX, datë 25.10.2010 datë 25.10.2010 “Mbi rregjimin e ri kontraktor për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”, drejtuar Neofone;
5. Shkresa e Neofone me nr.47 prot, datë 26.10.2010 “Përgjigje e shkresës së Vodafone Albania me nr. Reference LGD/0319/OX, datë 25.10.2010” drejtuar Neofone, për dijeni AKEP;
6. Shkresë e Neofone me nr.48 prot, datë 02.11.2010 “Kërkesë për sqarim në lidhje me bllokimin e njëanshëm nga Vodafone AL sh.a të qarqeve të interkoneksionit”, drejtuar Vodafone AL, për dijeni AKEP;
7. Shkresë e Neofone me nr.49 prot datë 03.11.2010 “ Përgjigje shkresës me nr. LGD/0319/OX, datë 25.10.2010, me subjekt mbi rregjimin e ri kontraktor për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare” drejtuar Vodafone AL, për dijeni AKEP;
8. Bashkëlidhur korespondenca me e-mail e shkëmbyer midis sipërmarrësve;
9. Relacion shpjegues mbi projektvendimin, (**Relacioni**);  
si dhe,
10. duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. Sipërmarrësi mNeofone sh.p.k me shkresën nr. 50 prot, datë 17.11.2010 (AKEP: nr. 3361 prot, datë 18.11.2010) në përputhje me pikën 1 të nenit 50 të ligjit nr.9918, datë

- 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me rregulloren e mosmarrëveshjeve miratuar me VKD nr. 1296 datë 11.06.2010, ka paraqitur ankim administrativ pranë AKEP;
2. Neofone është regjistruar pranë AKEP në regjistrin e sipërmarrësve me nr. 140 për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike;
  3. Neofone sqaron se, mosmarrëveshja midis palëve fillon me dërgimin nga Vodafone AL të Faksit me nr. Reference TD/CN/994/ND datë 02.10.2010 për Neofone. Vodafone AL, nëpërmjet kësaj shkrese i kërkon Neofone ndryshime për aksesin dhe modalitetet e interkoneksionit në facilitetet ekzistuese, dhe këto ndryshime varionin që nga mbyllja e aksesit për terminimin e trafikut ndërkombëtar në facilitetet ekzistuese deri tek mbyllja e kanaleve dhe restriktimi i aksesit në facilitetin e dhënë nga Vodafone AL në kuadër të MI datë 01.03.02010 me Neofone sh.p.k;
  4. Neofone sh.p.k me shkresën nr. 41 prot, dt. 07.10.2010 kundërshton politikën e Vodafone AL për restriktimin e Aksesit në facilitetet ekzistuese në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare duke i rikujtuar Vodafone AL që çdo ndryshim në aksesin e dhënë në facilitete përbën një shkelje të hapur të kuadrit rregullator duke i kërkuar mos ndryshimin e tyre;
  5. Gjithashtu Neofone i ka përsëritur Vodafone AL kërkesën e hershme ***për lidhjen e një qarku të dytë E1, meqënëse kjo kërkesë është e paplotësuar nga Vodafone AL si pasojë e pamundësisë teknike të Vodafone AL;***
  6. Për sa më sipër Neofone informon se Vodafone AL nuk ka kthyer përgjigje për shkresën e dërguar nga Neofone;
  7. Neofone, nëpërmjet shkresës ***me nr. 42 prot, datë 12.10.2010*** i bën ftesë zyrtare Vodafone AL për zhvillimin e negociatave me qëllim përcaktimin e tarifës së Interkoneksionit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare dhe për bisedimet e nevojshme për facilitetet te interkoneksionit dhe Aksesit;
  8. Vodafone AL, ne përgjigje të ftesës së Neofone zhvillon takimin dypalësh me Neofone më datë 20.10.2010, të cilin Neofone e konsideron të pasuksesshëm pasi Vodafone AL paraqet çmimin e përcaktuar në mënyrë të njëanshme, duke mos dhënë asnjë arsytim ligjor dhe financiar për këtë çmim të njëanshmën;
  9. Vodafone AL, me shkresën nr. LDG/0319/OX reference, datë 25.10.2010 derguar Neofone, bën zyrtare qëndrimin e saj ne takimin midis palëve duke përcaktuar çmimin e njëanshëm;
  10. Neofone në përgjigje të shkresës së më sipërme i dërgon Vodafone AL shkresën ***nr.47 prot, dt 26.10.2010*** ku i kërkon rishikimin e negociatave të çmimit midis tyre, në zbatim edhe të gjithë kuadrit ligjor në fuqi. Shkrese për të cilën Neofone nuk merr asnjë përgjigje nga Vodafone AL;
  11. Vodafone AL, më datë 01.11.2010 mbyll komplet aksesin në qarkun e interkoneksionit midis Neofone e Vodafone AL, dhe nëpërmjet email-it me dt. 01.11.2010 nga Vodafone AL, detyrohet të firmosë pranimin e çmimit të vendosur nga Vodafone AL, me qëllim hapjen e aksesit në kapacitetet e bllokuara;

12. Neofone, më pas dërgon shkresën me nr. 48 prot, datë 02.11.2010 për Vodafone AL dhe për dijeni AKEP, *“Kërkesë për sqarim në lidhje me bllokimin e njëanshëm nga Vodafone AL të qarqeve të interkoneksionit”*, për të cilën nuk merr asnjë përgjigje zyrtare nga Vodafone AL;
13. Neofone me shkresën nr. 49 prot, datë 03.11.2010 pranon zyrtarisht çmimin e vendosur nga Vodafone AL, më qëllim hapjen e aksesit, deri në daljen e AKEP me nje Vendim të ri në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.  
***Gjithashtu i rikërkon Vodafone AL, pranimin e shtimit të kapacitetit E1, pasi Neofone ka përgatitur infrastrukturën e nevojshme për implementimin e këtij kapaciteti, dhe së fundmi i bën të qartë Vodafone AL të drejtën për t’u ankimuar ne AKEP edhe pas pranimit të çmimit të njëanshëm të vendosur prej saj;***
14. Për sa me sipër Neofone thekson se Vodafone AL, ka hapur vetëm 3 nga 30 kanale të facilitateve ekzistuese;
15. Neofone konsideron se, Vodafone AL edhe pas publikimit të Vendimit nr. 1437, datë 03.11.2010 të KD të AKEP, nuk ka zhbllokuar aksesin në qarkun e Interkoneksionit, dhe se në mënyre jo zyrtare ka anuluar shtimin e facilitetit të ri E1, duke u shprehur sërish për mungese kapacitetesh;
16. Neofone thekson se, Vodafone AL vazhdon ta dëmtojë rëndë financiarisht, si dhe imazhin e saj kundrejt partnerëve duke shkelur çdo parim dhe princip të kuadrit rregullator në fuqi;
17. Për sa më sipër ***Neofone kërkon që AKEP të ndërhyjë në mënyrë të menjërshe bazuar në nenet 60, 135 dhe 137 të Ligj nr. 9918, datë 19.05.2010, për të zgjidhur në mënyrë ligjore mosmarrëveshjet për mbylljen e aksesit në mënyrë të njëanshme nga Vodafone AL, alokimin e qarkut të ri E1 të kërkuar nga Neofone, si dhe ripërcaktimin e qarqeve të modaliteteve të aksesit dhe interkoneksionit midis Neofone dhe Vodafone AL;***
18. AKEP per sa më sipër, ka dalë me Vendimin nr. 1437, dt.03.11.2010, duke mbajtur qëndrim ndaj problemit që Neofone së bashku me Operatorët e tjerë Alternativë kanë ngritur në lidhje ***me çmimin e trafikut të terminimit ndërkombëtare ndaj sipërmarrësit Vodafone AL***, të cilin e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) ;
19. AKEP, konsideron se, Vodafone AL si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg ka detyrimin për terminimin e thirrjeve ne rrjetet celulare dhe t’u ofroje palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij. Gjithashtu në zbatim edhe të nenit 50 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 zgjidhja e mosmarrëveshjes mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 te Rregullores së Brëndshme,

## **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis “Neofone” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
  - Jetmir Braha Kryetar
  - Florida Çela Anëtar
  - Xhenisa Nela Anëtar
  - Ded Jakaj Anëtar
  - Esmeralda Dervishi Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara “Neofone” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**